

1. Informacion i përgjithshëm

ARC sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NUIS K81728025F, në përputhje me ligjin 9901 datë 19.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është shërbime logjistike, organizim i udhëtimeve individuale dhe kolektive për stafe profesionale, rezervime, shërbime guide. Masterplane-studime rajonale dhe urbanistike.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Themistokli Gërmenji", Pallati përballë RTSH, Kati 1. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek dhe zotërohet nga ortaku i vetëm Z. Besnik Leskaj.

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 13 punonjës. (2018: 14 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlërësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlërësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

Shoqëria ka qira operative dhe financiare.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



4. Vlerësime kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare ne banke	13,641,621	43,016,148
Ne Leke	43,199	307,942
Ne monedhe	13,598,422	42,708,206
Mjete monetare ne arke	484,858	1,064,514
Ne Leke	484,858	1,064,514
	<u>14,126,479</u>	<u>44,080,662</u>

6. Huadhënie afatshkurtër

Huadhënia afatshkurtër më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Huadhënie M&P I	26,424,090	28,633,440
Hua ASG	27,500	6,171,000
	<u>26,451,590</u>	<u>34,804,440</u>

7. Hua afatshkurtër ndaj palëve të lidhura

Hua afatshkurtër ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Huadhënie Albrail	30,259,845	30,669,870
Huadhënie Besnik Leskaj	70,630,984	24,684,000
Huadhënie Blessed Investment	-	18,513,000
Huadhënie GBI	7,588,500	-
	<u>108,479,329</u>	<u>73,866,870</u>



ARC sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	6,830,754	1,334,244
	<u>6,830,754</u>	<u>1,334,244</u>

9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme tregtare Abkons	18,412,994	17,835,011
Të arkëtueshme nga Albrail	-	166,323
Te arkëtueshme nga GBI	21,919	-
TE arkëtueshme nga lkons	10,959	-
Të arkëtueshme nga BGP Southeast Europe	1,436,886	728,178
	<u>19,882,758</u>	<u>18,729,512</u>

10. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim fitimi i arkëtueshëm	2,033,461	8,677,159
TVSH leasing	4,037,670	4,037,670
TVSH e paguar ne dogane	1,859,557	-
Garanci të dhena	96,769	83,333
	<u>8,027,457</u>	<u>12,798,162</u>

11. Inventarë

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mallra	1,202,692	-
	<u>1,202,692</u>	<u>-</u>



ARC sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

14. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Punë në ambiente të marra me qera	Mjete transporti	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2018	8,770,063	571,184		88,505,012	97,846,259
Shtesa	4,218,206	97,325	10,091,060	16,404,071	30,810,662
Pakesime				(9,052,927)	(9,052,927)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	12,988,269	668,509	10,091,060	95,856,156	119,603,994
Shtesa	1,145,993	241,959	1,406,886		2,794,838
Pakesime				(6,056,547)	(6,056,547)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	14,134,262	910,468	11,497,946	89,799,609	116,342,285
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2018	5,677,474	309,360		15,662,866	21,649,700
Amortizimi i vitit	933,085	83,500	1,013,399	15,597,050	17,627,034
Pakesime				(2,735,438)	(2,735,438)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,610,559	392,860	1,013,399	28,524,478	36,541,296
Amortizimi i vitit	1,340,234	104,372	1,827,865	13,395,186	16,667,657
Pakesime				(2,519,978)	(2,519,978)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,950,793	497,232	2,841,264	39,399,686	50,688,975
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,377,710	275,649	9,077,661	67,331,678	83,062,698
Gjendja më 31 dhjetor 2019	6,183,469	413,236	8,656,682	50,399,923	65,653,310



15. Aktive afatgjata Jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

Kosto	AAJM
Gjendja më 1 janar 2019	-
Shtesa	158,434
Pakesime	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	158,434
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2019	-
Amortizimi i vitit	13,863
Pakesime	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	13,863
Vlera neto kontabël	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	144,571

16. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë në lekë	7,000,986	8,137,614
Furnitorë në monedhë	637,851	2,397,983
	7,638,837	10,535,597

17. Detyrime për qira financiare

Detyrimet e qirasë financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	9,893,972	12,495,130
Pjesa afatgjate e qirasë financiare	9,526,182	19,085,348
	19,420,154	31,580,478



18. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	318,320	387,410
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	366,272	503,815
Tatim në burim	234,730	-
TVSH për t'u paguar	4,409,681	2,623,826
	<u>5,329,003</u>	<u>3,515,051</u>

19. Garanci të marra

Garancitë e marra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Garanci të marra	695,886	695,886
	<u>695,886</u>	<u>695,886</u>

20. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj Abkons	-	34,613
Huadhënie Blessed Investment	14,612,400	-
Detyrime për dividend ndaj Besnik Leskaj	213,250,952	-
	<u>227,863,352</u>	<u>34,613</u>

21. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga të pagueshme	1,013,939	8,717
Detyrime për investime ne pjesëmarrje BGI	50,000	50,000
	<u>1,063,939</u>	<u>58,717</u>



22. Kapitali

Kapitali i nënshkruar nuk ka patur ndryshime dhe mbetet në total prej 100,000 lekë.
Fitim i mbartuar më 31 dhjetor 2019 është 0 lekë. (31 dhjetor 2018: 195,805,910 lekë).

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Numri i përgjithshëm i kuotave	1	1
Vlera nominale	100,000	100,000
	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shërbimet e logjistikës	149,513,678	201,232,120
Të ardhura nga qiraja	14,623,727	9,284,298
	<u>164,137,405</u>	<u>210,516,418</u>

24. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë të ardhurat të tjera të realizuara gjatë aktivitetit të shfrytëzimit si dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e aktiveve (neto)	173,974	44,627
Të ardhura nga kembimet valutore aktiviteti operativ (neto)	(2,286,948)	(10,508,271)
	<u>(2,112,974)</u>	<u>(10,463,644)</u>

Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale

Të ardhura nga shitja e AAM	3,710,542	6,362,115
Shpenzime nga shitja e AAM	(3,536,568)	(6,317,488)
Rezultati Neto nga shitja e AAM	<u>173,974</u>	<u>44,627</u>



25. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shërbim logjistike	14,059,961	68,175,484
Shpenzime qiraje	7,730,340	7,284,340
Karburant	6,679,500	11,693,439
Shpenzime për makinat	7,502,371	11,304,793
Shpenzime të tjera direkte	7,894,476	-
	43,866,648	98,458,056

26. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Personel jashtë njesisë	1,752,090	424,298
Transferime, udhëtime, dieta	1,865,011	2,446,505
Shërbime bankare	277,459	134,208
Taksa të ndryshme	201,000	189,833
Shpenzime të tjera	1,465,236	993,278
	5,560,796	4,188,122

27. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime paga	18,084,124	19,741,991
Shpenzime për sigurime shoqerore	1,837,153	2,194,320
	19,921,277	21,936,311

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 13 punonjës. (2018: 14 punonjës)



28. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi	16,681,520	17,627,034
	<u>16,681,520</u>	<u>17,627,034</u>

29. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjoha të ndryshme	2,418	133,769
Sponsorizime	414,503	-
Donacione	4,397,145	63,045
	<u>4,814,066</u>	<u>196,814</u>

30. Shpenzime financiare (neto)

Shpenzimet financiare (neto) detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për interesa	1,677,927	2,099,935
Te ardhura nga interesat	(195,537)	-
Humbje nga këmbimet valutore	-	(2,464,383)
	<u>1,482,390</u>	<u>(364,448)</u>



31. Shpenzime tatim fitimit

Shpenzimi I tatim fitimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	69,697,734	58,010,885
Total shpenzime të panjohura	627,208	739,109
Shpenzime per dhurata	126,250	
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	2,418	133,769
Vlera kontabël e AAM të shitura		107,911
Sponsorizime	414,503	
Shpenzime të tjera	84,037	497,429
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	70,324,942	58,749,994
Tatim fitimi @15%	10,548,741	8,812,499
	59,148,993	49,198,386

32. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Abkons	18,412,994	-	17,835,011	34,613
IKONS	10,959	-	-	-
Albanian Financial Institution	-	19,420,154	-	31,580,478
BGP Southeast Europe	1,436,886	-	728,178	-
Albrail	-	14,612,400	166,323	-
Besnik Leskaj	70,630,984	213,250,952	24,684,000	-
Blessed Investment	-	-	18,513,000	-
Albrail	30,259,845	-	30,669,870	-
GBI	7,610,419	-	-	-
	128,362,087	247,283,506	92,596,382	31,615,091



32. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Abkons	170,631,946	206,946	199,487,208	213,887
Albanian Financial Institution	537,533	15,157,921	216,425	13,233,992
Albrail	98,120	-	166,323	-
BGP Southeast Europe	8,719,788	-	7,227,371	-
Redjan Basha	-	-	-	-
Matrix Konstuksion	-	7,223,681	-	14,880,814
Arta Gurabardhi	-	-	-	-
Besnik Leskaj	-	-	-	-
	179,987,387	22,588,548	207,097,327	28,328,693

33. Angazhime dhe pasiguri*Çeshtje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

34. Ngjarje pas datës së bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që volume i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Shoqëria gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt.

Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "Vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.



